



REPUBLIKA E SHQIPERISË

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 2405 Prot.

Tiranë, më 15/07/2026

**V E N D I M**

**Nr. 18, datë 10.07.2026**

**P Ë R**

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR  
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI  
MATEMATIKE, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË  
MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË  
TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 374, datë 23.07.2024, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

**VENDOSI:**

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Transformime Integrale Hibride jo-lokale për modelimin e ekuacioneve diferenciale thyesore në modelimin e proceseve biologjike dhe imazherinë mjekësore, dinamikën tumorale;
2. Modelimi Hapësinor-Kohor i Incidencës së COVID-19 dhe Tuberkulozit në Shqipëri: Analizë Retrospektive dhe Parashikuese (2016-2035);
3. Sistem i integruar për parashikimin dhe parandalimin optimal të aksidenteve rrugore në Shqipëri: nga rreziku hapësinor-kohor te optimizimi i ndërhyrjeve;
4. Modele dinamike dhe stokastike në shkencat aktuariale;
5. Analiza e stilometrisë së teksteve shqip me metoda të avancuara statistikore dhe Inteligjencë Artificiale.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Matematike, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof. Dr. Akli Fundo**

